



## PROCESVERBAL

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)** - Rahovec, e mbajtur më **26.08.2025**, me fillim në orën **15:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 16 anëtarë. Mbledhja u mbajt në **Ratkoc**, në sallën e Qendrës Kulturore **“Jah Hoti” - Ratkoc**.

**Kryetari:** Më lejoni t’i përshëndes anëtarët e KKSB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, kapitenin Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, të shoqërisë civile, të komuniteteve pakicë, përfaqësuesit e FSK-së, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-s dhe zyrtarët komunalë. Është mbledhja e **katërt** e rregullt për vitin 2025 dhe sipas planit të punës e kemi këtu në Ratkoc, respektivisht në sallën e Qendrës Kulturore “Jah Hoti” - Ratkoc. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,  
- Siguria në trafik,  
- Masat për parandalimin e lëmshëkërkuesve,  
- Informatë dhe analizë nga policia e Komunës për çështjen e vjedhjeve dhe të sigurisë së përgjithshme;
3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2025-2026 dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;
4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta;
5. Trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegalë;
6. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit;
7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
8. Të ndryshme.

**Kryetari:** A ka dikush ndonjë koment për këtë rend dite? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është “për”?... A ka votë kundër?... Konstatoj që mund të vazhdojmë me këtë rend dite.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryetari:** A ka dikush dikush ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është “për”?... A ka votë kundër?... Vazhdojmë!

**2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:**

**Kryetari:** Pika e dytë e rendit të ditës i ka edhe nënpikat që po i shihni. Unë po shpresoj që ne jemi dakord që gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar dhe nuk kemi ndonjë situatë që e ka cenuar këtë gjendje të qëndrueshme. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit.

**Fazli Morina:** I nderuar kryetar! Përshëndetje për anëtarët e KKSB-së, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Si zakonisht do të raportoj në pika të shkurta rreth situatës së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, me statistika si në vijim: Gjatë këtij muaji, janë realizuar 10 plane operative, 10 urdhëresa operative. Kanë ndodhur 137 raste - 129 vepra penale, prej tyre 8 incidente jopenale, 15 raste vjedhje, 3 raste me para falco, 20 raste të kanosjes, 8 raste armëmbajtje pa leje dhe 19 raste të dhunës në familje. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë arrestuar 56 persona - prej tyre 32 persona janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Sa i përket sigurisë në komunikacion: Janë dhënë 1640 gjoba në komunikacion rrugor. Prej tyre, 48 gjoba janë shqiptuar për drejtimin e automjetit pa patent shofer, 15 gjoba për përdorim të telefonit gjatë vozitjes, 153 gjoba për parkingje joadekuate.

Puna në shkolla gjithashtu ka kaluar në rregull sa i përket pjesës tonë, janë realizuar 296 patrullime në afërsi të shkollave.

**Shaip Shala:** Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Vendosja e dy zebrave në fillim të rrugës "Sadedin Hajda" prodhon 100% efekt pozitiv, nëse e krahasojmë me gjendjen e mëparshme tani është për çdo lëvdatë. Me këtë rast e falënderoj ekzekutivin e komunës. Sa i përket lëmshëkërkuesëve: Masat për parandalimin e tyre mund të bëhet vetëm në kontrollim kufitar, sepse 90% e lëmshëkërkuesëve janë nga Shqipëria. Pra, zhdukja e kësaj dukurie mund të bëhet vetëm me këtë ide.

**Fazli Morina:** Faleminderit Shaip! Vendojsa e pengesave dhe zebrave është plan i ekzekutivit dhe është kënaqësi që e kemi këtë infrastrukturë. Te pyetja tjetër: Rahoveci është qytet q ka më së paku lëmshëkërkues në Kosovë. Numri i tyre është duke u zvogëluar dhe shumica janë nga Shqipëria. Ne e dimë si bëhen parandalimet, por ideja që e përmende nuk bën, sepse gjatë verës kufijtë janë të hapur dhe kjo mënyrë është e pamundur.

**Kryetari:** Faleminderit komandant! Faleminderit Shaip! Në vazhdimësi të kësaj pike e kemi edhe trajtimin e qenve endacakë. Këtë çështje, si komunë e kemi prioritet. Na mundon një strategji kombëtare, por kemi kontratë aktive për trajtimin e qenve endacakë. Sa i përket parkingut, asnjëherë nuk kemi pasur më shumë parkingje dhe të gjithë janë gratis. Ndriçimi publik, si element i rëndësishëm i sigurisë, këtë muaj ka funksionuar në rregull. Një person me emrin Igor Popoviq e kemi shpallur person "Non Grata" unanimisht në kuvend. Personi në fjalë e ka fyer UÇK-në dhe tani ai duhet të përballet me organet tona shtetërore.

### **3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2025-2026 dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla:**

**Kryetari:** Jemi duke i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor. Këtë pikë e kemi edhe në mbledhjen e rregullt të kuvendit dhe më gjerësisht do ta diskutojmë edhe aty.

### **4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta:**

**Kryetari:** Te pika e katërt: ne jemi të obliguar edhe ligjërisht që t'ju krijojmë hapësira dhe lehtësira personave me nevoja të veçanta - në parkingje, në objekte dhe institucione komunale, si dhe kudo tjetër. Meqë nuk ka dikush asgjë për të shtuar, vazhdojmë me pikën e pestë.

### **5. Trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegalë:**

**Kryetari:** E kemi deponinë për mbeturina të amvisërisë. Nuk mund të vendosim në çdo cep kamera, por në hapësira joadekuate nuk hedhen mbeturina. Të vetëdijesohemi një herë e mirë. Sidoqoftë, ne i kemi gjobat mjaft të larta. Si kryetar komune, kam vendosur që ta shpërblej atë që e lajmëron rastin e hedhjes ilegale të mbeturinave, varësisht prej dëmit të shkaktuar. Të gjitha informatat do të jenë konfidenciale për të gjithë ata që i lajmërojnë rastet. Ta ruajmë ambientin dhe të vazhdojmë të kontribuojmë për ambient të pastër.


**7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:**

**Kryetari:** Sot, mungon Nora, por sigurisht që drejtoresha e ka kryer punën e saj që harmonizohet me pikën e shtatë, rreth kontrollit të produkteve ushqimore, si dhe vazhdon përpjekja intensive për ushqim më cilësor me siguri më të lartë.

**8. Të ndryshme:**

**Kryetari:** A ka dikush ndonjë koment te pika e fundit? Nëse jo, atëherë ju ftoj për nga një kafe. Ju falënderoj për kontributin.

Procesmbajtësi

  
Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

  
Smajl Latifi



